

Nr. 6069/2 Prot.

Tiranë, më 25.07.2013

A U T O R I Z I M

Në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 140 "Përfaqësimi në asamble", me cilësinë e Aksionarit Shtetëror në shoqërinë "Bloja" sha Tirane, autorizoj Zj. Valentina Murashi, në Drejtorinë e Privatizimit të METE, të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, që do të mbahet në datën 26.07.2013, ora 11.00, në ambientet e shoqërisë.

MINISTRI

FLORJON MIMA



Nr. 6069/1 Prot.

Tiranë, më 25.07.2013

Lënda : Qëndrimi që do të mbahet në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve

Bazuar në Ligjin 9901 date 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e Aksionarit Shtetëror në shoqërinë " Bloja" Sha Tirane, në mbledhjen e datës 26.07.2013, thirrur nga Administratori i kësaj shoqërie, mban qëndrimin si më poshtë:

- Miraton pikën I të rendit të ditës " Miratimin e statutit të shoqërisë të përshtatur në përputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

MINISTRI

FLORJON MIMA



SHOQERIA "BLOJA" SH.A.

Nr. 01 Prot.

NJOFTIM PER MBLEDHJE TE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE AKSIONEREVE TE SHOQERISE "BLOJA" SH.A.

Drejtuar: Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, ne cilesine e aksionerit te shoqerise, zoteruese e 7.35% te kapitalit aksioner.

Ne vemendje te: Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve Tregtare
Drejtorise se Administrimit te Prones Publike

Te nderuar Zoterinj,

Ne perputhje me ligjin 9901, date 14.04.2008, neni 137 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ju njoftojme se me date 26.07.2013, ne oren 11:00, ne Seline e Shoqerise "BLOJA" sha. ne adresen: Rruga Kavajes, Tirane, do te zhvillohet mbledhja e Asamblese se Aksionereve te shoqerise "BLOJA" SH.A., sipas rendit te dites qe vijon:

1. Miratimi i Statutit të shoqërisë të përshtatur me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Shoqëritë Tregtare" dhe ligjin nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
2. Te ndryshme.

Ju lutem gjeni bashkelidhur draft statutin dhe mirepresim komentet tuaja.

Per sa me siper duke u bazuar edhe ne pashikimet e Ligjit "Per shoqëritë tregtare" ju lutemi te paraqiteni personalisht ose nga nje person tjetër i autorizuar prej jush.

Me respekt,
Shoqeria "BLOJA" SH.A.
Administratori
Z. Fuad Haxhiymeri

Tirane, me 04.07.2013



VENDIMI ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE AKSIONEREVE TE SHOQERISE "BLOJA" SH.A

Sot, me date 26.07.2013 ne seline e shoqerise "BLOJA" Sha.u u mbajt mbledhja e Asamblese se Aksionereve te shoqerise.

Shoqeria "BLOJA" sha, person juridik shqiptar regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare me vendim nr. 11826 qe date 02.08.1995 te Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ne mbledhje merrnin pjese aksioneret si me poshte:

1. **Z. Fuad Haxhiymeri**, shtetas shqiptar, lindur me 28.01.1964 ne Tirane, banues ne Tirane, i identifikuar me karten e identitetit numer 029017241, madhor dhe me aftesi te plote juridike per te vepruar;
2. **Z. Agron Haxhiymeri**, shtetas shqiptar, lindur me 24.03.1967 ne Tirane, banues ne Tirane, i identifikuar me karten e identitetit numer 031922967, madhor dhe me aftesi te plote juridike per te vepruar;
3. **Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes**, perfaqesuar me autorizim nr. 6069/2 prot, date 25.07.2013 nga Znj. Valentina Murashi shtetase shqiptar, lindur me 15.09.1962, ne Tirane, banuese ne Tirane, mbajtese e Kartes se Identitetit me nr. 024484433, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Administrator i Shoqerise eshte Z. Fuad Haxhiymeri.

Mbledhja e aksionereve kryesohet nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres Z. Agron Haxhiymeri.

Kryetari i Mbledhjes pasi konstatoi pranine e aksionereve te shoqerise qe zoterojne 98.69 % aksione te shoqerise dhe kuorumi i nevojshem per marrjen e vendimeve te vlefshme eshte realizuar, deklaroi ate te hapur dhe beri te ditur rendin e dites si me poshte:

1. Miratimi i Statutit të shoqërisë të përshtatur me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Shoqëritë Tregtare" dhe ligjin nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
2. Te ndryshme.

Kryetari i Mbledhjes u beri me dije te pranishmeve se me hyrjen ne fuqi te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Shoqëritë Tregtare", Asamblese se Aksionereve u lind detyrimi te pershtase organizimin dhe funksionimin e shoqerise ne perputhje me dispozitat e ketij ligji (neni 230/2).

Aksioneret e Shoqerise diskutuan ne lidhje me te gjitha ceshtjet e mesiperme dhe ne unanimitet Asambleja e Aksionereve,

VENDOSI:

1. Miratimin i Statutit të Shoqërisë të përshtatur me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Shoqëritë Tregtare" dhe ligjin nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
2. Autorizimin e seicilit prej Avokateve te studios ligjore "Ballanca Law Office" te realizoje procedurat e nevojshme per regjistrimin e ketij vendimi dhe Statutit perkatës pranë Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Duke mos patur ceshtje tjeter per te diskutuar, Kryetari i mbledhjes e deklaroi ate te mbyllur.

AKSIONERET E SHOQERISE "BLOJA" SH.A

Z. Fuad Haxhiymeri

FUAD HAXHIYMERI

[Signature]

Z. Agron Haxhiymeri

Agron Haxhiymeri

[Signature]

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes,
perfaqesuar nga Znj. Valentina Murashi

Valentina Murashi

[Signature]



shqip
E SHTUNE, 6 KORRIK 2013

SOCIALE

SHOQERIA "BLOJA" SH.A

NJOFTIM PER MBLEDHJE TE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE AKSIONEREVE TE SHOQERISE

Te nderuar Zoterinj,
Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, neni 137 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ju njoftojmë se më datë 26.07.2013, në orën 11:00, në Selinë e Shoqërisë "BLOJA" sha në adresën: Rruga Kavajës, Tirane, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë "BLOJA" SH.A, sipas rendit të ditës që vijon:

1. Miratimi i Statutit të shoqërisë të përshtatur me Ligjin NR. 9901, datë 14.04.2008, Për Shoqëritë Tregtare dhe ligjin nr 9723, datë 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
2. Te ndryshme

STATUTI
I
SHOQËRISË ANONIME PA OFERTE PUBLIKE
"BLOJA" SH.A.

Aksioneret e shoqërise kanë vendosur përpilimin dhe përshtatjen e statutit të shoqërise "BLOJA" sh.a. në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit".

NENI 1
EMERTIMI DHE STATUSI LIGJOR

Emertimi i shoqërise është "**BLOJA**" **SH.A.** (me poshtë referuar si "Shoqëria"), ajo është një person juridik i organizuar në formën e një shoqërie anonime pa oferte publike. Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetes të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore.

NENI 2
Selia

Selia zyrtare e shoqërise ndodhet në adresën: **Rruga "Kavajes", Tirane, Shqipëri**. Për të ushtruar aktivitetin e saj dhe për qëllime të aktivitetit të saj, shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyrë përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
Emri dhe logo janë pronë e shoqërise.

NENI 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e papercaktuar në kohë dhe ka filluar aktivitetin që nga regjistrimi i saj me datë 02.08.1995 me vendimin nr. 11826 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.



NENI 4 OBJEKTI

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:

- Perpunimin, prodhimin, shperndarjen, tregtimin dhe shitjen e miellit dhe te nenprodukteve te tij si dhe produkteve ushqimore me baze mielli.
- Import-Eksportin te te gjitha llojeve te mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, minerale etj.
- Te operoje ne fushen e turizmit, peshkimit, trasportit rrugor dhe uJOR, etj.
- Cdo opercion financiar, tregtar, industrial, etj qe lidhet ne menyre te drejteperdrejte apo te terthorte me objektin e veprimtarise se shoqerise.
- Cdo aktivitet tjeter tregtar i cili lejohet nga ligjislacioni shqipetar ne fuqi dhe qe eshte ne funksion te permbushjes se veprimtarise primare te shoqerise.

NENI 5 AKSIONERET DHE KAPITALI

Kapitali i shoqerise eshte 1.209.649.000 (njemilarde e dyqind e nente milione e gjashteqind e dyzet e nente mije) leke e ndare ne 1.209.649 (njemilion e dyqind e nentemije e gjashte qind e dyzet e nente) aksione, me nje vlere nominale 1.000 leke (njemije leke) secili aksion.

Nje aksion i shoqerise mund te zoterohet nga nje apo me shume persona. Personat qe zoterojne ne menyre te perbashket nje aksion, me marredhenie me shoqerine, ushtrojne te drejtat e aksionarit, nepermjet nje perfaqesuesi te perbashket dhe pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet, qe rrjedhin nga zoterimi i aksionit. Vprimet e shoqerise ndaj aksionit te zoteruar nga me shume persona krijojne pasoja ndaj te gjitha zoteruesve te tij, edhe nese veprimi i shoqerise i drejtohet vetem njerit prej tyre.

Aksionere e shoqerise jane personat te cilet rezultojne te regjistruar ne regjistrin e aksioneve dhe ne regjistrin e Qendres Kombetare te Rregjistrimit dhe ata kane te drejta te plota si per marredheniet me shoqerine, ashtu edhe ndaj te treteve.



NENI 6 PARIMET

1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, aksionarët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të aksionarëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji për shoqëritë tregtare ose nga statuti, në rrethana të njëjta, aksionarët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Sa me sipër perjashton shprehimisht të drejtat e lidhura me aksionet të cilat për të menjanaur cdo dyshim janë në përputhje me aksionet e zoteruara në shoqëri

NENI 7 Sekreti tregtar

1. Sekreti tregtar është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument, që shoqëria mbron në mënyra të përshtatshme, i cili, nëse do t'u përhapej personave të paautorizuar, do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm të interesave tregtarë të shoqërisë.
2. Administratori apo anëtarët e këshillit mbikëqyrës, si dhe përfaqësuesit e punëmarrësve përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkakuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme, padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë duhet të ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes.

NENI 8

Emertimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e përfaqësuesve të shoqërisë duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tjerëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Të gjitha shkresat, formularet apo cdo dokument tjetër korespondence, nxjerre nga shoqëria, deget apo zyrat e përfaqësimit, nepërmjet përdorimit të letres ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:



- a) - numrin unik te identifikimit;
- b) - formen ligjore te shoqerise;
- c) - vendodhjen e selise se rregjistruar dhe zyres qendrore te saj;
- d) - te dhenat relative nese shoqeria eshte ne likujdim.

NENI 9

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të Aksioneve

Aksionet e një shoqërie dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te aksioneve me kontrate, Kontrata duhet te behet me shkrim.

Aksionet jane lirisht te transferueshme midis Aksionereve.

Aksioneri ka te drejte te transferoje pjesen e tij ne kapitalin e shoqerise, personave te trete qe nuk jane pjese e shoqerise, pas miratimit nga Asambleja e Pergjithshme.

Ne rast se shoqeria do te jete me me shume se nje aksioner, aksioneri i cili do te transferoje apo shese aksionet e tij, duhet ti dergoje nje njoftim me shkrim administratorit te shoqerise, duke i ofruar me pare keto aksione, aksionereve te tjere, ne te cilet te tregohen te dhenat dhe cmimi i shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe i njejte me ate qe do ti ofrohet nje pale te trete.

E drejta e parablerjes se Aksionereve do te ushtrohet ne raport me pjeset e tyre ne kapitalin e shoqerise.

Personi qe transferon aksionin dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i aksionit, nga casti i kalimit te aksionit deri ne castin e regjistrimit te kalimit.

NENI 10

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Aksioneret mund te vendosin te zmadhojne ose zvogelojne kapitalin e shoqerise ne perputhje me dispozitat e

neneve 168-186 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 per tregtaret dhe shoqerite tregtare.

KONTROLLI DHE ADMINSTRIMI I SHOQERISE
NENI 11
ORGANET
DREJTUESE

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

- a. Asambleja e Pergjithshme
- b. Keshilli Mbikëqyres dhe
- c. Administratori.

NENI 12
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe, emërimin dhe revokimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;
- dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.



NENI 13 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët, nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës apo me kërkesë të aksionarëve të shoqërisë.
3. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse:
 - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.
 - b) kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
4. Në rastet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar i pavarur.

NENI 14 Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë, me njoftim publik, ose nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Ky njoftim duhet të përmbajë, gjithashtu:
 - a) emrin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;
 - b) një sqarim të hollësishëm të procedurave, që duhet të ndiqen nga aksionarët, për të marrë pjesë dhe votuar në asamble.
3. Në rastin kur shoqëria aksionare ka shumë aksionarë, thirrja e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme mund t'u njoftohet aksionarëve edhe nëpërmjet botimit të informacioneve si më sipër në një gazetë të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin.



NENI 15
Përfaqësimi në Asamble

1. Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

NENI 16
Kuorumi

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 17
Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim, në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera, me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.



NENI 18

Përfashtimi nga votimi

1. Aksionari nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës, nëse asambleja e përgjithshme duhet të marrë vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) faljen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Në rastet kur aksionari përfaqësohet me autorizim, ky ndalim zbatohet edhe për personin e autorizuar.

NENI 19

KESHILLI MBIKQYRES

Të drejtat dhe detyrimet

Këshilli Mbikqyres ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
- c) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- ç) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e Këshilli Mbikqyres për t'u paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të Këshilli Mbikqyres për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

f) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

g) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja.

NENI 20

Numri, emërimi dhe përbërja e Këshilli Mbikqyres

1. Këshilli Mbikqyres përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.

2. Anëtarët e Këshilli Mbikqyres zgjidhen nga asambleja e përgjithshme, për një periudhë jo më të gjatë se 3 vjet. Anëtarët e Këshilli Mbikqyres mund të rizgjidhen.

3. Aksionarët, të cilët zotërojnë së bashku një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind ose një vlerë më të vogël të kapitalit të regjistruar, kanë të drejtën të emërojnë një anëtar të Këshilli Mbikqyres me një vendim të posaçëm. Anëtarët e zgjedhur në këtë mënyrë nuk mund ta rrisin numrin e anëtarëve të Këshilli Mbikqyres mbi numrin maksimal prej 21 anëtarësh.

Ne datën në të cilën behet i vlefshëm ky statut, Këshilli Mbikqyres do të ketë këto perberje për një afat 3 vjeçar:

a. Kryetar: Z. Agron Haxhiymeri, shtetas shqiptar, lindur me 24.03.1967 në Tiranë, banues në Tiranë, i identifikuar me kartën e identitetit numer 031922967, madhor dhe me aftësi të plote juridike për të vepruar.

b. Nenkryetare: Znj. Sabina Kedhi, shtetase shqiptare, lindur me 13.05.1982 në Tiranë, me vendbanim në Tiranë, mbajtese e Kartës së Identitetit me nr. 027858921, madhore me zotësi të plote për të vepruar.

c. Anetare: Znj. Silvana Hakcani, shtetase shqiptare, lindur me 11.10.1962 në Tiranë, me vendbanim në Tiranë, mbajtese e Kartës së Identitetit me nr. 024403860, madhore me zotësi të plote për të vepruar.

Cdo anetar i Keshillit Mbikeqyres i pushon se qeni i tille si pasoje e doreheqjes, shkarkimit, paaftesise apo vdekjes, do te zevendesohet nepermjet emerimit te nje anetari te ri te zgjedhur me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Anetari i ri do te qendoje ne detyre deri ne perfundimin e mandatit te anetarit te vjeter. Ne periudhen midis dy mbledhjeve te Asamblese, Administratori do te jete ai qe do kryeje emerimet e perkohshme.

Anetarët e keshillit mbikqyres nuk mund te jene ne te njejten kohe edhe administratore te Shoqerise. Ne rast se nje prej anetareve te keshillit mbikqyres do te emerohet si administrator, mandati i tij ne keshillin mbikqyres do te perfundoje ne momentin e transferimit te tij ne pozicionin e ri.

NENI 21 Zgjedhshmëria e kufizuar

1. Anëtarët e këshillit mbikqyres mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve dhe punëmarrësve të shoqërisë tregtare, si edhe nga radhët e individëve të tjerë, jashtë shoqërisë.
2. Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i këshillit mbikqyres, nëse ai, njëkohësisht, është:
 - a) anëtar i këshillit të administrimit ose i këshillit mbikqyrës në 2 shoqëri të tjera, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;
 - b) është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë;
 - c) është administrator i një shoqërie tjetër, e cila ka si administrator ose anëtar të këshillit të administrimit një anëtar të këshillit të administrimit apo të këshillit mbikqyrës të shoqërisë së parë.
3. Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me pikën 2 të këtij neni, është absolutisht i pavlefshëm.
4. Anëtarësimi në këshillin mbikqyrës apo këshillin e administrimit të shoqërive të tjera të një grupi vlerësohet si anëtarësim vetëm në një bord.
5. Individët, që kandidojnë për t'u emëruar si anëtarë të këshillit mbikqyres detyrohen të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi e anëtarësie në këshillat e shoqërive të tjera.

NENI 22 Shkarkimi

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit mbikqyres, me shumicë të thjeshtë votash. Kjo e drejtë nuk mund të përjashtohet nga statuti apo me marrëveshje. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 23

Kryetari dhe procesverbalet

1. Këshilli mbikqyres duhet ta zgjedhë kryetarin dhe nënkryetarin e tij, në përputhje me dispozitat e statutit. Nënkryetari ushtron tagrat e kryetarit, kur ky i fundit është në pamundësi për t'i kryer ato personalisht.
2. Zhvillimi i mbledhjeve të këshillit mbikqyres regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të marra. Secili anëtar ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.

NENI 24

Marrja e vendimeve

1. Vendimet e këshillit mbikqyres vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron.
2. Vendimet e këshillit mbikqyres mund të merren sipas përcaktimeve të statutit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje.
3. Përjashtimet nga e drejta e votës, sipas nenit 21 të këtij statuti, zbatohen edhe për anëtarët e këshillit mbikqyres.

NENI 25

ADMINISTRATORËT

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet me te drejte rizgjidhje.

Emërimi prodhon pasojë pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i Shoqërisë për periudhën e parë 3 vjeçare është **Z. Fuad Haxhiymeri**, madhor me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar.



Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.

Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit mbikqyres të një shoqërie të kontrolluar dhe administratori i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të

jetë kryetar i këshillit mbikqyres të shoqërisë mëmë. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto

dispozita është absolutisht i pavlefshëm.

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

- a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit mbikqyres për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
- d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë;
- e) të raportojnë përpara këshillit mbikqyres për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
- ë) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj.

Detyrat, që i cakton ligji këshillit mbikqyres, nuk mund t'u delegohen administratorëve.

Asambleja e përgjithshme mund t'i shkarkojë administratorët në çdo kohë. Padi të, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 26 AUDITIMI FINANCIAR

Mbledhja e Asamblese së Aksionareve emeron një ekspert të certifikuar kontabël si auditor të pavarur për periudhën e përcaktuar me ligj. Auditori i pavarur do të jetë i



emeruar per nje periudhe nje vjecare. Shoqeria ka te drejten te emeroje nje ose me shume auditore.

Auditoret e pavarur do te kene te drejten per te analizuar te gjitha rastet e devijimit te procedurave ligjore fiskale te kryera nga Aksionaret, ne menyren e percaktuar ne Ligjin per Shoqerite Tregetare.

Eksperti kontabel i Shoqerise do te jete:

Znj. Lefteri Kushta, lindur me 15.10.1958 ne Tirane, me vendbanim ne Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr. 024397196 dhe i pajisur me license profesionale nr. 58, date 10.02.2000, madhor me zotesi te plote per te vepruar.

NENI 27

Auditoret e Pavarur duhet te certifikojne te gjithe pasqyrat financiare vjetore te jene te sakta, te redaktuara ne menyre te qarte dhe te permbajne nje pasqyre reale te operacioneve tregetare te shoqerise bashke me fondet e mbartura te saj, ne fund te cdo viti financiar.

Detyra e tij kryesore do te jete verifikimi i librave dhe fondeve te shoqerise si dhe perputhja e mbajtjes se librave te shoqerise me legjislacionin ne fuqi. Ata kane per detyre gjithashtu te verifikojne saktesine dhe perputhjen e llogarive vjetore me informacionin e paraqitur ne raportet e administratorit si dhe ne dokumenta te tjere qe I adresohen aksionareve dhe qe lidhen me situaten vjetore financiare. Auditoret e pavarur do te sigurojne vezhgimin e investimeve midis aksionareve.

NENI 28 VITI FINANCIAR

Viti financiar fillon ne ditën e pare te janarit dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Ne raste te vecanta viti financiar do te filloje ne daten kur shoqeria eshte regjistruar dhe do te zgjase deri me 31 dhjetor te te njejtit vit.

NENI 29 INVENTARI, PASQYRAT VJETORE FINANCIARE



Ne perfundim te cdo viti finaciar, Administratori pergatit raportin vjetor te pasqyrave financiare, ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi mbi kontabilitetin dhe bashke me bilancin vjetor, i paraqet ato perpara Keshillit Mbikeqyres dhe ne Mbledhjen e Asamblese se Aksionereve.

Rezervat apo fondet e detyrueshme reserve duhet te krijohen duke marre ne konsiderate fitimet pergjate vitit finaciar, duke hequr ketu humbjet e vitit te meparshem dhe duke lene menjane nje fitim neto prej 5%. Cdo vendim ne kundershkrim me kete nen do te jete i pavlefshem. Rezervat nuk do te perbejne nje detyrim kur vlere e rezerves se detyrueshme eshte e barabarte me 1/10 e kapitalit. Mbledhja e Asamblese se Aksionareve mund te krijojte edhe lloje te tjera fondesh, pervec fondeve te parashikuara ne nenin e mesiperm.

Fitimi neto I realizuar qe ka rezultuar pas zbritjes se shpenzimeve si dhe vleres se fondit reserve, do tu kaloje aksionareve ne perputhje me perqindjen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise ose mund te kaloje per investime me nje vendim te Asamblese se Aksionareve.

NENI 30

Shoqëria anonime priset:

- Kur mbaron periudha kohore për të cilën është themeluar;
- Me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- Me hapjen e një procedure falimentimi;
- Nëse nuk janë kryer aktivitetet tregtare për dy vjet;
- Me vendim të gjykatës;
- Për arsye të tjera.

Ulja e numrit të aksionarëve në një të tillë nuk çon në shpërbërjen e shoqërisë.


NENI 31

LIKUJDIMI I SHOQERISE

Ne rastet kur Shoqeria priset, ajo i nenshtrohet procedurave te likujdimit. Shoqeria do te likujdohet ne perputhje me rregullat e percaktuara nga Legjislacioni Shqiptar dhe ky statut.

Asambleja e Pergjithshme, Brenda 30 diteve nga prishja e shoqerise, vendos me shumicen e anetareve te pranishem, te emeroje nje likuidues.

Te dhenat e likuiduesve se bashku me tagrat e tyre te perfaqesimit te shoqerise, i njoftohen per rregjistrim Qendres Kombetare te Rregjistrimit nga administratori i shoqerise.



NENI 32
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde si pasoje e interpretimit dhe zbatimit te ketij Satuti, si dhe cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Aksionareve te shoqerise,do te zgjidhet nga Autoriteti Kompetent Gjyqesor qe do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 33
DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Te gjitha ceshtjet qe nuk gjejne nje rregullim te posacem ne kete statut do te rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil ne fuqi apo nga dispozitat ligjore te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregetare" si dhe ndryshimet qe mund ti ndodhin ketij ligji Ky statut eshte hartuar ne kater kopje me vlere te njejte ne gjuhen shqipe..

AKSIONERET E SHOQERISE "BLOJA" SH. A

Z. Fuad Haxhiymeri

FUAD HAXHIYMERI
[Signature]

Z. Agron Haxhiymeri

Agron Haxhiymeri
[Signature]

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, perfaqesuar nga Znj. Valentina Murashi

Valentina Murashi
[Signature]

